

PRAGË - KARLOVY VARY Nisje: • 27 Nëntor

DESTINACIONI

Pragë

PERIUDHA

Festat e Nëntorit '2026

KOHËZGJATJA

4 Ditë

TRANSPORTI

Me Avion

PËRMBLEDHJE



FESTAT E NËNTORIT 2026



Nisje 27 Nëntor - Kthim 30 Nëntor

- 4 Ditë / 3 Netë
- Çmimi: **449€**
-  Nisja: 18:40 (Tiranë) → 20:45 (Pragë)
-  Kthimi: 21:20 (Pragë) → 23:15 (Tiranë)

1

PRAGË

DITË

Takimi në aeroportin e Tiranës me shoqëruesin 2 orë përpara fluturimit.

Fluturimi direkt Tiranë – Pragë . (1 ore : 40 min)

Mbërritja në Aeroportin e Pragës.

Pas përfundimit të formaliteteve aeroportuale, takimi me autobusin dhe transferimi drejt hotelit.

Mbërritja në hotel, akomodimi dhe sistemimi në dhoma.

Fjetje në Pragë.

2

PRAGË

DITË

Mëngjesi në hotel.

Pas mëngjesit nisja për një ditë të plotë kushtuar zbulimit të **Pragës**, një prej kryeqyteteve më të bukura dhe më të vizituara të Europës.

Vizita fillon në zonën monumentale të **Hradčany**, ku ndodhet kompleksi i famshëm i **Prague Castle**, një nga simbolet kryesore të qytetit.

Gjatë turit do të vizitohet dhe shohim:

- Prague Castle dhe Hradčany
- Katedralen madhështore **St. Vitus**
- Lagjen historike **Malá Strana**
- **Charles Bridge**, ura më e famshme e Pragës
- Sheshin e Qytetit të Vjetër - **Old Town Square**
- **Astronomical Clock**, ora e famshme astronomike e Pragës
- Kishën e **Our Lady before Týn**
- Rrugicat karakteristike të Qytetit të Vjetër

Pushim për drekë.

Pasdite vazhdojmë shëtitjen dhe vizitat në qendrën historike të qytetit, me mundësi për të shijuar atmosferën e Pragës dhe **tregjet tradicionale të Krishtlindjeve**, të cilat në këtë periudhë i japin qytetit një atmosferë të veçantë.

Në mbrëmje kthimi në hotel.

Opsionale: Lundrim në lumin Vltava ose darkë tradicionale çeke.

Fjetje në Pragë.

Mëngjesi në hotel.

Pas mëngjesit nisja drejt **Karlovy Vary**, një nga qytetet termale më të famshme të Europës, i njohur për arkitekturën elegante, burimet termale dhe historinë e tij shumëvjeçare.

Udhëtimi nga Praga drejt Karlovy Vary zgjat rreth 2 orë.

Pas mbërritjes, nisja e vizitës së qytetit.

Gjatë turit do të shohim:

- **Mill Colonnade**
- **Market Colonnade**
- **Hot Spring Colonnade**
- Burimet e famshme termale të qytetit
- Kishën **St. Mary Magdalene**
- Shëtitoren historike përgjatë lumit Teplá
- **Grandhotel Pupp**, një nga hotelet simbol të Karlovy Vary
- Qendrën historike dhe ndërtesat karakteristike të qytetit

Kohë për drekë dhe për të shijuar atmosferën e qytetit. Mundësi për të provuar ujërat e burimeve termale dhe produktet tradicionale të Karlovy Vary.

Pasditë nisja për kthim drejt Pragës.

Mbërritja në Pragë në mbrëmje.

Fjetje në Pragë.

Mëngjesi në hotel.

Check-out dhe nisja për **ditën e dytë të vizitave në Pragë**, këtë herë duke eksploruar zona të tjera historike dhe moderne të kryeqytetit çek.

Vizita fillon me **Vyšehrad**, një nga vendet historike më të rëndësishme të Pragës, i vendosur mbi një kodër me pamje të bukur mbi lumin Vltava dhe qytetin.

Gjatë paradites do të vizitojmë:

- Kompleksin historik **Vyšehrad**
- Bazilikën e **Shën Pjetrit dhe Palit**
- Fortifikimet dhe pikat panoramike mbi Pragë
- **Dancing House**, një nga ndërtesat moderne më karakteristike të qytetit
- Shëtitoren përgjatë lumit **Vltava**
- **National Theatre**

Vazhdimi drejt zonës së **Nové Město - New Town**, ku do të shohim:

- **Wenceslas Square**
- **National Museum**
- Bulevardet dhe ndërtesat karakteristike të Qytetit të Ri

Pushim për drekë.

Pas drekës vazhdojmë drejt **Josefov - Jewish Quarter**, lagjja historike hebraike e Pragës. Shëtitje në këtë pjesë të qytetit dhe në zonën elegante të **Pařížská Street**.

Pas përfundimit të vizitave, nisja drejt Aeroportit të Pragës.

Kalimi i procedurave doganore dhe nisja për në Tiranë me fluturim direkt (1 ore : 40 min)

✓ PËRFSHIHET

- ✓ Udhëtimi vajtje-ardhje me avion Tiranë – Pragë – Tiranë. Transferrat dhe Shëtitjet me autobus sipas programit. Akomodimi në hotel 4 Yje në Pragë për 3 netë. Ekskursioni në Kalorvë Vary. Mëngjeset për të gjitha ditët e udhëtimit në hotel. Mëngjeset për të gjitha ditët e udhëtimit. Guida në gjuhën shqipe gjatë Turit. Lejohet të merret me vete në avion vetëm një çantë me përmasa 40cm x 30cm x 20cm deri në 10 kg. (Kujdes – Mbi këto përmasa dhe Bagazh për checkin ka shpenzime ekstra).

× NUK PËRFSHIHET

- × Drekat dhe Darkat. Hyrjet në monumente dhe muzeume. Taksa lokale 4 eur personi për natë (e detyrueshme dhe paguhet në zyrë bashkë me pagesën e turit)

VENDTAKIMI I NISJES

- Nga aeroporti Nënë Tereza, ku duhet të paraqiteni minimumi 2 orë përpara

POLITIKAT E ÇMIMIT PËR FËMIJËT

- Fëmijët në moshën 2 – 11.99 vjeç përfitojnë 40€ zbritje nga cmimi i paketës

Shenim: Kjo politike hyn në fuqi vetëm nëse fëmijët akomodohen në dhomë me 2 të rritur.

DOGANA

- 1) Pashaportë me vlefshmëri minimumi 3 muaj
- 2) Nuk duhet të keni kaluar në 6 muaj e fundit më shumë se 90 ditë qëndrimi në vendet e BE

INFORMACIONE

- Akomodimi në dhomë teke (single) është me ekstra pagesë në vlerën 30% mbi çmimin për person.
 - Nëse krevati nuk do të jetë dopio, atëherë do të jenë dy krevatë teke të bashkuar.
 - Nëse shtrati për personin e tretë/katërt nuk do të jetë standart, atëherë do të jetë sofa bed (shtrat i shtuar në dhomë).
 - Operatori Turistik nuk mban përgjegjësi për personat e kthyer nga policia për arsye të ndryshme sic janë mungesë dokumentacioni, ekspuls, skadencia e mjetit identifikues, etj.
 - Nëse nuk i keni mbushur 18 vjeç dhe udhëton pa praninë e njërit ose asnjërit prej prindërve, ju nevojitet prokurë e noterizuar në gjuhën angleze.
 - Ekziston mundësia që disa nga përmbajtjet e hotelit/udhëtimit të mos jenë aktualisht në funksion për shkak të rrethanave objektive, të cilat operatori nuk mund të ndikojë.
 - Çmimet dhe disponueshmëria e muzeumeve, ekskursioneve dhe cdo aktivitet tjetër lokal mund të ndryshojnë dhe janë përgjegjësi e vetë Operatorëve Lokale që mundësojnë këto shitje.
- Për cdo ndryshim në lidhje me këto aktivitete, klienti lajmërohet përpara kryerjes së shërbimit.
- Kujdesi ndaj sendeve personale gjatë qëndrimit në aeroplan, autobuz, traget, është përgjegjësi individuale e klientit dhe jo e Operatorit

DESTINACIONI	Pragë
TRANSPORTI	Me Avion
ÇMIMI	€499.00 / person
ZBRITJE FËMIJË	98% (€8.00)
GJENERUAR	03/09/2026 06:07